



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .08.2024

MBLEDHJA Nr. 31,
Datë 29.08.2024, ora 09:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 29.08.2024, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 31 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 31.07.2024 dhe datë 26.08.2024.
2. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023, “Mbi propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave”, si dhe vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.05.2024, “Mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX për tregun brenda së njëjtës ditë”.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “BMG ENERGY SAL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KOTORRI”.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.08.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2MW”, i ndryshuar.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI